



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA KULTURORE DHE KLUBI I SPORTIV LUSHNJE
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Lushnje më, ____/____/2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Transport i Artisteve, Veteraneve dhe Klubit të Shumësporteve”
Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodet CPV: 60140000-1, Transport i udhëtarëve i paplanifikuar, 63510000 – 7, Agjenci udhëtimi dhe shërbime të ngjashme 63520000 -0 Agjensi transporti

VLERA E FONDIT LIMIT TOTAL /VLERA E PRITSHME E KONTRATAVE: 2 083 248 (dy milion e tetëdhjetë e tre mijë e dyqind e dyzet e tetë) lekë pa T.V.SH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 **“Për Prokurimin Publik”** i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të V.K.M. Nr. 285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”**, autoriteti/enti kontraktor Qendra Kulturore dhe Klubi Sportit Lushnje ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim ofertë, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 **“Për Prokurimin Publik”** i ndryshuar, në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të V.K.M. Nr.285 datë 19.05.2021 **“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”**.

b. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar në nenin 76 të Ligjit nr.162/2020 **“Për Prokurimin Publik”** i ndryshuar, dhe nenin 26 të V.K.M. Nr. 285, datë 19.05.2021 **“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”**, në të cilën është e përcaktuar se: **“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”**

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Sipas kriterëve të përgjithshme të Pranim/Kualifikimit

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin

2.2.1 Kopje të deklaratës së xhiros mesatare vjetore të dy viteve të fundit (2022, 2023) lëshuar nga Administrata Tatimore, e cila duhet të jetë 40% e vlerës së parashikuar të kontratës.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky vërtetim duhet të paraqitet nga secili prej pjestarëve të bashkimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 **“Për Prokurimin Publik”** i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës.; në pikën 1 dhe pikën 2/c të nenit 43 të V.K.M.-së nr. 285, datë 19.05.2021 **“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”**, ku përcaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;*

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të O.E. ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga A.K.

2.2.2. Kopje të certifikuara të bilancit të konfirmuar me vulë pranë Autoriteteve Përkatëse (Administrata Tatimore) të dy viteve (2021,2022) të fundit që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter duhet të plotësohet nga çdo anëtar i bashkimit sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”**.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në ligjin nr.25/2018 **“Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”**.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Punë të ngjashme (e cila provon përvojën e mëparshme) për shërbime të ngjashme në një vlerë jo më të madhe se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet, dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 **“Për Prokurimin Publik”** i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4(b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”**. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik fitues duhet të ketë në listëpagesë të paktën 2 (dy) drejtues automjeti, i cili do të jetë në gadishmëri të A.K. sipas kërkesave të këtij të fundit.

Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për 3 muajt e fundit (*Tetor, Nëntor, Dhjetor 2023*), shoqëruar me listëpagesat e sigurimeve shoqërore (*formularët E-sig 025 a*) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore.

Drejtuuesi i autobusit duhet të ketë:

1. Patentë e kategorisë D, (*eksperience deri në 2 vjet*)
2. Kontratë pune të rregullt.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 **“Për Prokurimin Publik”** i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”**, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Disponimi i mjeteve:

Operatori ekonomik fitues duhet të disponojë të paktën 2 (dy) autobusë (*në pronësi ose me qira*) me vit prodhimi 2008 e sipër të cilët do të jenë në gadishmëri pranë A.K. gjatë afatit të zbatimit të kontratës të A.K. dhe sipas kërkesave të këtij të fundit.

• Autobusi minimalisht 48 vendësh i pajisur me dokumentacion të plotë:

Për automjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

1. Leje qarkullimi e automjetit (*dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit*);
2. Liçencë për transport udhëtarësh (*çertifikatë*) brenda dhe jashtë vendit;
3. Çertifikatë e kontrollit teknik të automjetit;
4. Akti i vlerësimit teknik i automjetit;
5. Siguracioni i mjetit;
6. Siguracioni i udhëtarëve;
7. Tahograf (*i kolauduar*);
8. Foto e automjetit.

Për automjetet që janë me qera duhet të paraqiten përveç sa më sipër edhe kontrata përkatëse e qirasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 **“Për Prokurimin Publik”** i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”**, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë hartuar nga specialistet e fushës.

Kriteret e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga specialistët e fushës pjesë e njësisë së prokurimit.

Njësia e Prokurimit